



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 17, datë 04.03.2019

PËR

**MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “LIRENG AUDITING” SH.P.K., PËR
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË BYROSË SHQIPTARE TË
SIGURIMIT PËR VITIN FINANCIAR QË MBYLLET NË 31.12.2018**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 123, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, nenit 42, të Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, si dhe të Rregullores nr. 37, datë 28.05.2015 “Për përcaktimin e kriterëve dhe kërkesave për përzgjedhjen e shoqërisë audituese për shoqërinë e sigurimit”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e shoqërisë audituese “Lireng Auditing” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për vitin financiar që mbyllet në 31.12.2018.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI**